VENDIM
Nr. 75, datë 15.3.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR PAJISJE ME CERTIFIKATË TË GARANCISË SË ORIGJINËS TË IMPIANTIT FOTOVOLTAIK TË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NË DIGËN E QYRSAQIT, HEC "VAU I DEJËS", TË SHOQËRISË "KORPORATA ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE" SHA

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 16, të ligjit nr. 7/2017, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"; neneve 7 dhe 8 të "Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 229, datë 20.12.2019; si dhe nenit 19, pika 1, germa "d", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.3.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 991/1 prot., datë 13.3.2023, të drejtorive teknike të ERE-s, "Mbi fillimin e procedurës për pajisje me certifikatë të garancisë së origjinës të impiantit fotovoltaik të prodhimit të energjisë elektrike në digën e Qyrsaqit, HEC "Vau i Dejës", të shoqërisë "Korporata Elektroenergjetike Shqiptare" sh.a.",

konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 991 prot., datë 3.3.2023, shoqëria "Korporata Elektroenergjetike Shqiptare" sh.a., ka paraqitur kërkesën për pajisjen me Certifikatën e Garancisë së Origjinës të impiantit fotovoltaik të prodhimit të energjisë elektrike në digën e Qyrsaqit, HEC "Vau i Dejës", të shoqërisë "Korporata Elektroenergjetike Shqiptare" sh.a., për periudhën 13.5.2022–31.12.2022.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 187, datë 21.7.2022, është vendosur kualifikimi i këtij impianti fotovoltaik.

- Në zbatim të "Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme", dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria "Korporata Elektroenergjetike Shqiptare" sh.a. rezulton i plotësuar aneksi 1, germat "a" dhe "c"; neni 7, pika 7.4, germat "a" dhe "c" germat "a", "b", "c", "ç", "d", "e", "ë" dhe "g"; neni 7, pika 7.5, pika 1 germat "a", "b", "c", "d", pika 2 germat "a", "b", "c".

Në kuadër të plotësimit të këtij aplikimi, shoqëria duhet të depozitojë në ERE:

- Në lidhje me sasinë reale të prodhuar nga ky impiant për vitin 2022 (nga data 13.5.2022 deri më 31.12.2022), ERE do t'i drejtohet OST sh.a. me një kërkesë për sasinë e energjisë elektrike faktike të prodhuar nga ky impiant gjatë kësaj periudhe.

Aneksi 1, "Formati i aplikimit":

- germa "b", aktin përkatës të përfaqësimit/autorizimin e përfaqësuesit ligjor.

Neni 7, pika 7.4:

- germa "f", shoqëria duhet të depozitojë çdo dokument tjetër të lëshuar që dëshmon kolaudimin dhe komisionimin e impiantit prodhues të energjisë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për pajisjen me Certifikatë të Garancisë së Origjinës të impiantit fotovoltaik të prodhimit të energjisë elektrike në digën e Qyrsaqit, HEC "Vau i Dejës", të shoqërisë "Korporata Elektroenergjetike Shqiptare" sh.a., për periudhën 13.5.2022–31.12.2022.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti